



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Vendim nr. 4

“Mbi korigjimin e vendimi nr. 135 datë 05.04.2019”

Sot në datë 30.04.2019, trupi gjykues, ora 10:00 i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Pamela Qirko	Anëtare
Firdes Shuli	Relatore

Bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative: “Korigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ” sipas të cilit përcaktohet se:

- 1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
- 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.*

U mbledh për t’u njohur me kërkesën e relatorit të çështjes znj. Firdes Shuli, për korigjimin e një gabimi material në vendimin e subjektit të rivlerësimit Albana Boksi:

Në vendimin nr. 135 datë 05.04.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në faqen 15, në pikën 2, paragrafi 4, ku është shprehur se “... për të cilat ka paguar shpenzime në vlerën 100.000 lekë në muaj, ndërsa për vitin 2016, ka paguar shumën 100.000 lekë në muaj...”, të korigjohet si “...për të cilat ka paguar shpenzime në vlerën 10.000 lekë në muaj, ndërsa për vitin 2016, ka paguar shumën 10.000 lekë...”.

Trupa pasi konstatoi se kërkesa e relatores qëndron dhe pasaktësia është vendosur dukshëm si pasojë e një gabimi (lapsusi) në vendim.

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 135 datë 05.04.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në faqen 15, në pikën 2, paragrafi 4, ku është shprehur se “... për të cilat ka paguar shpenzime në vlerën 100.000 lekë në muaj, ndërsa për vitin 2016, ka paguar shumën 100.000 lekë në muaj...”, të korigjohet si vijon “...për të cilat ka paguar shpenzime në vlerën 10.000 lekë në muaj, ndërsa për vitin 2016, ka paguar shumën 10.000 lekë...”.
2. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerin Publik dhe Vëzhguesin Ndërkombëtar për këtë korigjim.

3. Vendimi i korrigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda Çiftja
Pamela Qirko
Firdes Shuli

Kryesuese
Anëtare
Relatore

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 157 Akti

Nr. 135 Vendimi
Tiranë, më 05.04.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Relatore
Pamela Qirko	Anëtare
Etleda Çiftja	Kryesuese

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare znj. Maria Tuma, më datë 4 prill 2019, dhe më datë 5 prill 2019, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Albana Boksi**, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Nenet 179/b, A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, të ndryshuar, me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji relatimin dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Albana Boksi, proces i cili ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tri kritereve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, dhe në përfundim, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Albana Boksi është subjekti i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, dhe në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “Ligji nr. 84/2016”), të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Albana Boksi, ushtron funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, për periudhën shkurt 2006 - maj 2011, si dhe për periudhën maj 2014 - aktualisht. Ky subjekt është hedhur në short nga Komisioni me shortin e datës 15.05.2018.

3. Me shkresën nr. *** prot., datë 05.02.2018, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. *** prot., datë 11.05.2018, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ka vënë në dispozicion aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit, znj. Albana Boksi (12 fletë).

4. Me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2017, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, me nr. *** prot., datë 04.01.2019, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka vënë në dispozicion raportin mbi kontrollin e figurës të deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së, nr. *** prot., datë 26.12.2018, për subjektin e rivlerësimit, znj. Albana Boksi (2 fletë).

5. Me shkresën nr. *** prot., datë 14.02.2019, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. *** prot., datë 01.03.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vënë në dispozicion raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Albana Boksi (30 fletë).

6. Bazuar në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka zhvilluar shortin, më datë 15.05.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Albana Boksi, do t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Etleda Çiftja dhe Firdes Shuli. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.

7. Me fillimin e procesit të rivlerësimit, trupi gjykues administroi:

7.1 Aktin për vlerësimin e pasurisë, sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016, të hartuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (në vijim “ILDKPKI”).

7.2 Raportin e vlerësimit të figurës, sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016 nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”).

7.3 Raportin e vlerësimit profesional, sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGJ”).

8. Me vendimin nr. ***, datë 25.05.2018, trupi gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit, znj. Albana Boksi, duke përfshirë të tri kriteret, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Etleda Çiftja. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

9. Me vendimin nr. ***, datë 19.03.2019, trupi gjykues vendosi:

9.1 Të përfundojë hetimin paraprak administrativ për të tri kriteret e parashikuara në nenin 4, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, kriterin e pasurisë, të figurës dhe aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Albana Boksi.

9.2 Të miratojë rezultatet paraprake të hetimit.

9.3 Të njoftojë subjektin e rivlerësimit se provat e grumbulluara lidhur me vlerësimin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, kanë nivelin e provueshmërisë sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, duke i kaluar atij barrën e provës mbi rezultatet paraprake të hetimit kryesisht, për të paraqitur prova e shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, sipas parashikimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

9.4 Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për të drejtat e tij në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

9.5 Të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi deklarimin e konfliktit të interesit, të drejtën për t’u njohur me dosjen, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitareve, si dhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar konflikt interesi.

10. Më datë 30.03.2019, subjekti vuri në dispozicion në rrugë elektronike parashtresë me sqarimet e saj dhe dokumente shkresore bashkëngjitur.

11. Me vendimin nr. ***, datë 01.04.2019, trupi gjykues, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Albana Boksi, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 04.04.2019, ora 10:30, pranë Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve).

12. Më datë 04.04.2019 u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, znj. Albana Boksi, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit, dhe vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”*, trupi gjykues, vendosi të përfundojë procesin e

rivlerësimin për subjektin e rivlerësimin, znj. Albana Boksi, bazuar në të tre komponentët: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

II.1. VLERËSIMI I PASURISË

II.1.a. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Nga aktet e ILDKPKI-së rezulton se subjekti ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private për vitet 2003 - 2016 në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Më datë 30.01.2017, subjekti ka dorëzuar “Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimin Kalimtar”, pranë ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 32/1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky institucion ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimin dhe personave të lidhur, sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe me aktin nr. *** prot., datë 05.02.2018, ka konkluduar se:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

II.1.b. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimin, në përfundim të të cilit paraqet raport me konstatimet përkatëse, në lidhje me vlerësimin pasuror. Referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nr. 2/2017^[1] dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, ka kryer një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është kushtëzuar nga përfundimet e paraqitura nga ILDKPKI-ja.

Lidhur me pasuritë e subjektit të rivlerësimin, znj. Albana Boksi, është kryer një proces i plotë hetimi administrativ, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në deklaratimet e subjektit pranë ILDKPKI-së, provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar pranë Komisionit, çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të

^[1] “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimin është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimin”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimin të subjekteve të rivlerësimin kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimin kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, si dhe komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të këtij ligji dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Hetimi paraprak administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë, konsistoi në:

- a) Verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur;
- b) Verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë;
- c) Evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive;
- ç) Evidentimin e deklarimeve të rreme;
- d) Nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit,

me qëllim verifikimin nëse subjekti ka bërë deklarime të pamjaftueshme për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të ligjit.

Me certifikatë familjare të lëshuar, më datë 16.01.2017, nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Nr. ***, Tiranë, me nr. ***, rezulton që subjekti i rivlerësimit, znj. Albana Boksi, është familjar i vetëm dhe nuk ka persona të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 13, të cilët mbartin detyrimin për deklaram në zbatim të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ nga ana e Komisionit, sipas neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84 /2016, është kryer në lidhje me pasuritë e subjektit të rivlerësimit, si vijojnë:

1. Apartament banimi, porositur me kontratë porosie lidhur, më datë 08.12.2015, me sip. 77.3 m², me çmim 7.034.300 lekë, në Tiranë. Shuma prej 3.034.300 lekësh është paguar me lidhjen e kontratës së porosisë, me burim krijimi kursime personale, mbyllja e një depozite bankare të përbashkët me babain, si dhe një pjesë e marrë hua. Shuma prej 4.000.000 lekësh është përfituar me kredi bankare. Pjesa takuese: 100 %.

ZVRPP-ja Tiranë¹, konfirmon se, znj. Albana Boksi, ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, ZK ***, apartament, me sip. 68.20 m², sip. të përbashkët 9.1 m².

OSHEE-ja² konfirmon se, znj. Albana Boksi, është përdoruese e kontratës me nr. ***, e cila në sistem i përket shoqërisë “****”, të ndodhur në, Rr. “****”, Tiranë, duke dërguar informacion për shpenzimet e energjisë elektrike për këtë konsumator. Ky informacion përputhet me deklaramet e subjektit³.

1.1. Kjo pasuri është deklaruar në deklaratat periodike si vijon:

- Në deklaramin për vitin 2015 është deklaruar një apartament banimi, porositur sipas kontratës së porosisë lidhur, më datë 08.12.2015, me sip. 77.3 m², me çmim 7.034.300 lekë, ndodhur në Tiranë (një pjesë e çmimit është paguar/kësti i parë; pjesa tjetër e çmimit/vlerës së apartamentit, do të përballohet me kredi bankare).

¹ Shih shkresën kthim përgjigje nr. ***prot., datë 18.10.2018, të ZVRPP-së Tiranë në dosjen e Komisionit.

² Shih shkresën kthim përgjigje nr. ***prot., datë 06.11.2018, nga OSHEE-ja në dosjen e Komisionit.

³ Shih përgjigjet e pyetësorit të 2-të dërguar nga subjekti, më datë 20.10.2018, në dosjen e Komisionit.

Burimi i shumës së paguar si këst i parë janë: kursime personale, mbyllja e një depozite bankare të përbashkët me babain, si dhe një pjesë e marrë hua. Pjesa takuese: 100 %.

- Në deklaratën “Vetting”, si në pikën 1 më sipër, me po të njëjtat deklaratime.

Kjo pasuri është blerë me kontratë përfundimtare të shitjes, më datë 19.07.2017, pra, pas deklaratës “Vetting” dhe është deklaruar nga subjekti në deklarinimin periodik për vitin 2017.

Nuk ka pasaktësi apo mospërputhje në deklaratime.

1.2 Lidhur me mënyrën e krijimit të pasurisë dhe mënyrën e likuidimit, gjatë hetimit administrativ, u konstatua se:

- Me kontratën nr. ***, datë 08.12.2015, “Porositje për blerje apartamenti”⁴, znj. Albana Boksi, ka porositur ndërtimin dhe blerjen e apartamentit, me sip. ndërtimi 77.3 m², i përbërë nga 68.2 m² + 9.1 m², në vlerën 50.245 euro, ose 7.034.300 lekë.

- Sipas nenit 3, pikës 3.2, të kësaj kontrate, është paguar kësti i parë në vlerën prej 3.034.300 lekësh, me nënshkrimin e kontratës. Sipas pikës 3.3 të kontratës, blerësi do të paguajë këstin e dytë dhe të fundit, në vlerën prej 4.000.000 lekësh me kredi bankare.

- Me faturën e datës 07.12.2015 të “Raiffeisen Bank” vërtetohet se znj. Albana Boksi, ka derdhur për llogari të palës shitëse “****” sh.p.k., shumën prej 3.034.450.00 lekësh⁵.

- Me kontratë kredie dhe hipoteke nr. ***, datë 20.02.2016, znj. Albana Boksi, ka marrë pranë “Raiffeisen Bank” kredi në shumën prej 4.000.000 lekësh, me afat shlyerjeje 120 muaj⁶, me qëllim blerje apartamenti sipas kontratës së porosisë me nr. ***, datë 08.12.2015. Si garanci për shlyerjen e kësaj kredie është vënë pasuria me nr. ***, e ndodhur në lagjen: “****”, Rr. “****”, Nr. ***, Shkodër, në emër të prindërve të subjektit, B. e M. B.

- Më datë 01.03.2016, kredia në shumën prej 4.000.000 lekësh, ka kaluar në llogari të subjektit dhe, më datë 02.03.2016, ka kaluar nga znj. Albana Boksi në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k.⁷

- Me kontratë shitjeje nr. ***, datë 19.07.2017⁸, pasuria është regjistruar pranë ZVRPP-së Tiranë, më datë 21.07.2017.

Nuk ka pasur dyshime e paqartësi lidhur me mënyrën e fitimit të pronësisë dhe likuidimin e çmimit të blerjes së kësaj pasurie sipas marrëveshjes së palëve kontraktuese në kontratën nr. ***, datë 08.12.2015, “Porositje për blerje apartamenti “.

1.3 Lidhur me burimin e krijimit

Sipas deklaratimeve të subjektit, për këstin e parë në shumën prej 3.034.300 lekësh, paguar në vitin 2015 në momentin e lidhjes së kontratës së porosisë, kanë shërbyer:

⁴ Shih kontratën e porosisë në aneksin nr. ***në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵ Shih faturën në aneksin ***në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶ Shih kontratën e kredisë dhe hipotekës në aneksin nr. ***në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷ Shish shkresën nr. ***, datë 18.09.2018, nga “Raiffeisen Bank”.

⁸ Shih dokumentet bashkëngjitur me përgjigjet e pyetësorit të dytë dërguar nga subjekti, më datë 24.10.2018, në dosjen e Komisionit.

1.3.a. Kursime personale dhe mbyllja e një depozite bankare të përbashkët me babain⁹.

Lidhur me këtë burim, është pyetur subjekti mbi kontributin e saj dhe të babait në depozitën e përbashkët, si dhe burimin e të ardhurave të babait. Në përgjigje të kësaj pyetjeje, znj. Albana Boksi, ka sqaruar se¹⁰, “...kontributi në momentin e çeljes së kësaj depozite në vitin 2007 ka qenë në masën 50 % me 50 %, kurse derdhjet e mëvonshme, të vitit 2008, janë kontributi i saj i vetëm. Pjesa e kontributit të babait është rrjedhojë e kursimeve të prindërve nga puna e tyre ndër vite, si dhe një pjesë nga shitja e një toke të trashëguar nga babai. Ndërsa, pjesa e kontributit të saj është rrjedhojë e kursimeve nga paga, të cilat i dispononte cash (në fund të vitit 2006, në vlerën 600.000 lekë, kursime në cash)...”

Subjekti ka vërtetuar pretendimet e saj me dokumentet shkresore të administruara dhe të marra në konsideratë gjatë analizës financiare, si vijojnë:

- vërtetim nr. *** prot., datë 13.10.2016, i lëshuar nga “BKT”-ja, sipas të cilit vërtetohet se znj. Albana Boksi, ka hapur llogari, depozitë e hapur, në vitin 2007, kur është derdhur edhe shuma prej 7.000 eurosh, e cila është mbyllur në vitin 2015;
- kontratë shitblerjeje trualli nr. ***, datë 08.08.1996, sipas të cilës shitësit Xh.B dhe S.B i kanë shitur blerësit Q.T., truall me sip. 500 m², të ndodhur në lagjen “****”, në vlerën prej 710.000 lekësh. Këtë pasuri, prindërit e subjektit e kanë fituar në bazë të vendimit nr. ***, datë 14.06.1994, të Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave, ish-pronarëve, Shkodër;
- vërtetime nga DRSSH-ja Shkodër, në lidhje me punësimin e prindërve ndër vite.

1.3.b. Hua e marrë nga shtetasi Ç.B., djali i xhaxhait të subjektit, vërtetuar me deklaratën noteriale nr. ***, datë 11.05.2015¹¹, në shumën prej 10.000 eurosh, jashtë zyrës noteriale, pa afat.

Lidhur me këtë hua dhe mundësinë financiare të dhënies së saj nga burime të ligjshme, gjatë hetimit administrativ, rezultoi se:

- Shtetasi Ç.B., është shtetas italian i cili jeton dhe banon aktualisht në Itali.
- Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 11.05.2015¹², ai deklaroi se i ka dhënë hua subjektit të rivlerësimit, në shumën prej 10.000 eurosh, jashtë zyrës noteriale, pa afat.
- Nga verifikimi në sistemin *TIMS* rezultoi se, më datë 11.05.2015 (data e dhënies së huas), shtetasi Ç.B., ka qenë në Shqipëri dhe është larguar drejt Italisë, në orën 18:20, të po kësaj date.
- Subjekti ka vënë në dispozicion dokumente të nxjerra nga sistemi kompjuterik, të përkthyer, noterizuar dhe të legalizuara me vulë APOSTILLE¹³, si dhe një certifikatë familjare të shtetasit Ç.B., me përbërjen e tij familjare në kohën e dhënies së huas¹⁴, të cilat vërtetojnë se ky shtetas ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për vitet 2014 dhe 2015, për të dhënë huan prej 10.000 eurosh në vitin 2015, pasqyruar në tabelën më poshtë:

⁹ Shih transaksionet bankare të dërguara nga “Raiffeisen Bank”, në dosjen e Komisionit.

¹⁰ Shih përgjigjet e pyetësorit drejtuar subjektit, më datë 07.12.2018, në dosjen e Komisionit.

¹¹ Shih deklaratën noteriale në aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹² Shih deklaratën noteriale në aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹³ Shih dokumentet bashkëngjitur me parashtrimet pas kalimit të barrës së provës, dërguar nga subjekti në rrugë elektronike, datë 30.03.2019, në dosjen e Komisionit.

¹⁴ Shih certifikatën familjare nr. *** prot., datë 12.03.2019, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit të datës 11.03.2019, në dosjen e Komisionit.

Vitet	Të ardhura bruto nga punësimi	Zbritje	Bonus	Të ardhura neto
2014	13.157	2.043	205	11.319
2015	17.185	2.198	941	15.928
TOTALI	30.342	4.241	1.146	27.247

Nga analiza financiare për vitin 2015, bazuar në deklaratat periodike, si dhe dokumentet e administruara gjatë hetimit administrativ, rezulton se subjekti ka pasur mundësi financiare për të paguar këstin e parë për blerjen e pasurisë nr. ***, në shumën prej 3.034.450 lekësh.

Lidhur me këstin e dytë të paguar për blerjen e kësaj pasurie, u vërtetua se me kontratë kredie dhe hipoteke nr. ***, datë 20.02.2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Albana Boksi, ka marrë në “Raiffeisen Bank” kredi në shumën 4.000.000 lekë, të cilat kanë kaluar në llogari të shoqërisë “***” sh.p.k., më datë 02.03.2016¹⁵.

Në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se, për këtë pasuri nuk ka pasur pasaktësi në deklarime dhe as dyshime lidhur me fitimin e pronësisë. Gjithashtu, nga analiza financiare, rezultoi se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e apartamentit me nr. pasurie ***.

2. Automjet, tip “Ford Fusion”, viti i prodhimit 2010, kaluar në pronësi, më datë 17.07.2015, me çmim 11.200 euro. Burim krijimi: një pjesë nga kursime personale, ndërsa pjesa tjetër me kredi të llojit *leasing* me afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 17.08.2010. Është deklaruar për deklaratën “Vetting”, shlyerja e plotë e kredisë *leasing*, më datë 17.07.2015, sipas kontratës *leasing* – në vlerën 6,000 euro. Pjesa takuese: 100 %.

DPSHTRR-ja ka konfirmuar¹⁶ mjetin tip “Ford”, me targë TR ***, në pronësi të subjektit Albana B. Boksi.

2.1 Kjo pasuri është deklaruar në deklaratat periodike, si vijon:

- Në deklarinimin për vitin 2010, është deklaruar automjet, tip “Ford Fusion” blerë, më datë 19.07.2010, me çmim 11.200 euro, nga shoqëria “***” sh.p.k. Vlera e paguar është 5.200 euro. Pjesa tjetër e çmimit, paguar me kontratë qiraje financiare, me shoqërinë “***” sh.a., në vlerën 6.000 euro. Shlyerja e qirasë ka filluar, më datë 17.08.2010, me afat 5-vjeçar, deri më datë 17.07.2015.

- Në deklarinimin për vitin 2015, është deklaruar automjet tip “Ford Fusion” – kaluar në pronësi, më datë 17.07.2015, pas shlyerjes së plotë të kredisë së llojit *leasing*, me afat 5-vjeçar.

- Në deklaratën për “Vetting”, është deklaruar si në pikën 2 më sipër.

Nuk ka pasaktësi apo mospërputhje në deklarime.

2.2 Lidhur me mënyrën e krijimit të pasurisë dhe likuidimin e çmimit të blerjes, rezultoi se:

¹⁵ Shih shkresën nr. ***prot., datë 18.09.2018, nga “Raiffeisen Bank”.

¹⁶ Shih shkresën nr. *** prot., datë 20.09.2018, të DPSHTRR-së në dosjen e Komisionit.

- Me kontratën e qirasë financiare, nr. ***, datë 28.07.2010, si dhe shtojcës nr. 1 të saj¹⁷, “****” ka vërtetuar dhënien me qira të autoveturës, sipas deklarimeve të subjektit.

- Me kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 15.07.2015¹⁸, znj. Albana Boksi, ka blerë nga shoqëria “****” sh.a., automjetin tip “Ford Fusion”, me targë TR ***, pasi është likuiduar tërësisht çmimi i shitjes, sipas vërtetimit të lëshuar nga “****”, më datë 31.03.2016¹⁹.

Nuk u konstatuan paqartësi apo dyshime lidhur me këtë pasuri, ndërkohë që nga analiza financiare për vitin 2010, vit në të cilin është porositur makina tip “Ford Fusion”, rezultoi e vërtetuar se, subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e kështit prej 6.200 eurosh.

3. Pasuria, tokë arë, me sip. 1000 m², ndodhur në fshatin *, Velipojë, në bashkëpronësi, blerë më datë 11.01.2005. Pjesa takuese: 25 %, në vlerën 500.000 lekë. Burimi i krijimit: kursimet personale deri në vitin 2005.**

ZVRPP-ja Shkodër²⁰ ka konfirmuar të regjistruar në emër të znj. Albana B. Boksit, dhe bashkëpronarëve të tjerë, B. K. Ll, A.K.Ll, B.D.B, pasurinë e llojit arë me nr. pasurie ***, me sip. 1000 m², të ndodhur në ***, Shkodër. Gjithashtu, konfirmohet se me anë të urdhrin nr. ***prot., datë 11.10.2010, të ZVRPP-së Shkodër, është regjistruar kufizimi i pasurisë²¹.

3.1 Kjo pasuri është deklaruar në deklaratat periodike, si vijon:

- Në deklarinimin për vitin 2005, është deklaruar pasuri e paluajtshme (tokë), me sip. 1000 m² ndodhur në fshatin ***, Plazh, Shkodër, në bashkëpronësi me shtetasit B.K.Ll, A.K. Ll, B.D.B. Çmimi i blerjes 2.000.000 lekë. Pjesa zotëruese: 25 %.

- Në deklaratën “Vetting” është deklaruar si në pikën 3 më sipër.

Nuk ka pasaktësi apo mospërputhje në deklarime.

3.2 Lidhur me origjinën e pasurisë dhe mënyrën e fitimit të pronësisë:

U rikërkua informacion nga ZVRPP-ja Shkodër, dhe ky institucion ka vënë në dispozicion dokumente shkresore,²² me të cilat u vërtetua se:

- Shtetasi Rr.P., (pronari i parë) ka qenë pronar²³ i sip. 10.680 m², e llojit arë, ndodhur në ***, Plazh, me nr. ***, ZK ***, vol. ***, f. ***, përfituar me AMTP-në sipas ligjit nr. 7501/1991, e cila është ndarë²⁴ në tre pasuri me sipërfaqe: S1=1000 m²; S2=500m²; S3=9180 m².

¹⁷ Shih kontratën në aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁸ Shih kontratën e shitblerjes në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁹ Shih vërtetimin në aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁰ Shih shkresën kthim përgjigje nr. ***prot., datë 24.10.2018, nga ZVRPP-ja Shkodër në dosjen e Komisionit.

²¹ Bazuar në Vendimin e Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë mbi tokën bujqësore, nr. ***, datë 22.09.2009, si dhe në vendimin, nr. ***, datë 16.10.2009, të cilët e kanë vlerësuar si të pavlefshëm aktin e marrjes së tokës në pronësi të dhënë në favor të shtetasit Rr.F.P., nga i cili rrjedh edhe kjo pasuri që kufizohet.

²² Shih shkresë kthim përgjigje, nr. *** prot., datë 20.11.2018, nga ZVRPP-ja Shkodër, në dosjen e Komisionit.

²³ Shih vërtetimin pronësie të lëshuar, më datë 22.11.2004, nga ZVRPP-ja Shkodër, bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje, nr. ***prot., datë 20.11.2018, nga ZVRPP-ja Shkodër, në dosjen e Komisionit.

²⁴ Shih plan rievimi të përgatitur, më datë 07.12.2004, bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 20.11.2018, nga ZVRPP-ja Shkodër, në dosjen e Komisionit.

- Me kontratën nr. ***, datë 17.12.2004, shitësi Rr.P., dhe familjarë të tij, i kanë shitur blerësit I.D., pasurinë nr. ***, të llojit arë, me sip. 1000 m², në vlerën 1.000.000 lekë.

- Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 11.01.2005²⁵, shitësi I.D., i ka shitur blerësve, B. Ll., A.Ll., B.B., dhe Albana Boksi, sip. 1000 m², të ndodhur në ***, Plazh, Shkodër, në vlerën 2.000.000 lekë, vlerë kjo e likuiduar jashtë zyrës noteriale.

- Pasuria është regjistruar pranë ZVRPP-së Shkodër²⁶, në emër të bashkëpronarëve B.Ll., A.Ll., B.B., dhe Albana Boksi, si pasuria me nr. ***, në ***, Plazh, i llojit arë me sip. 1000 m².

Është pyetur subjekti²⁷ në lidhje me gjendjen aktuale të kësaj pasurie dhe ajo deklaroi se, *“Pasuria e paluajtshme “tokë – arë”, ndodhur në fshatin ***, Velipojë, nuk ka asnjë ndryshim nga gjendja e saj fillestare – vijon të jetë tokë arë, dhe në të nuk ka asnjë ndërtim”*. Ndërkohë, ky pretendim vërtetohet edhe me faktin se kjo pasuri është e kufizuar që në vitin 2010 nëpërmjet urdhrin nr. *** prot., datë 11.10.2010, të ZVRPP-së Shkodër²⁸.

Për vërtetimin e faktit se mbi këtë tokë nuk ka ndërtime apo procedura legalizimi, Drejtoria e ALUIZNI-t, Zonat Turistike,²⁹ informoi se shtetasit Albana B. Boksi, B.K.Ll., A.K.Ll., dhe B.D.B., nuk rezultojnë vetëdeklarues pranë kësaj drejtorie.

Për vërtetimin e konfliktit të mundshëm të interesit, gjatë hetimit administrativ, u kryen verifikime, nga të cilat nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur në shqyrtim çështje gjyqësore ku pjesëmarrës në gjykim të kenë qenë ish-pronari i pasurisë apo bashkëpronarët e tjerë të truallit.³⁰

Për sa më sipër, nuk ka rrethana që të vërtetojnë se subjekti i rivlerësimit mund të jetë favorizuar në blerjen e kësaj pasurie, për shkak të funksionit të saj si gjyqtare, dhe Komisioni krijoi bindjen se kjo pasuri është fituar prej saj në mënyrë të ligjshme.

3.3. Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie:

Janë deklaruar kursimet personale deri në vitin 2005.

Për të verifikuar nëse subjekti ka pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie, është kryer analiza financiare për vitin 2005, në tabelën si më poshtë:

1	Pasuri	500,000
----------	---------------	----------------

²⁵ Shih kontratën në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁶ Shih certifikatën e pronësisë në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁷ Shih përgjigjet e pyetësorit të dytë dërguar nga subjekti, më datë 24.10.2018, në dosjen e Komisionit.

²⁸ Sipas të cilit është regjistruar kufizimi i pasurisë, bazuar në Vendimin e Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë mbi tokën bujqësore nr. ***, datë 22.09.2009, si dhe në vendimin nr. ***, datë 16.10.2009, të cilët e kanë vlerësuar si të pavlefshëm aktin e marrjes së tokës në pronësi të dhënë në favor të shtetasit Rr.F.P., nga i cili rrjedh edhe kjo pasuri që kufizohet.

²⁹ Shih shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 18.12.2018, nga ALUIZNI, për Zonat Turistike, në dosjen e Komisionit.

³⁰ Shih vërtetimin nr. *** prot., datë 15.11.2018, lëshuar nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda; vërtetim nr. *** prot., datë 14.11.2018, lëshuar nga Gjykata e Apelit Shkodër; vërtetim nr. *** prot., datë 15.11.2018, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan; vërtetim nr. *** prot., datë 14.11.2018, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit të datës 12.11.2018, drejtuar subjektit, në dosjen e Komisionit.

	Pasuri tokë me sip. 1000 m ² , në fshatin ***, Shkodër, me pjesë takuese: 25 %.	500,000
2	Të ardhura	817,488
	Të ardhura nga paga e subjekti të dokumentuara	817,488
3	Shpenzime	381,286
	Shpenzime jetese	160,714
	Shpenzime udhëtimi sipas <i>TIMS</i>	220,572
4	Likuiditete në fillim të vitit	0
	Gjendje <i>cash</i>	0
5	Likuiditete në fund të vitit	209,563
	Gjendja e llogarisë së subjektit në “Raiffeisen Bank”	9,563
	Gjendje <i>cash</i>	200,000
	Diferenca (2+4-1-3-5)	-273,362

Nga kjo analizë, bazuar në deklaratimet e subjektit dhe dokumentet e administruara, nga hetimi paraprak, rezultoi se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e tokës në shumën prej 500,000 lekësh, për shkak të një mungese likuiditeti në vlerën prej 273.362 lekësh.

Lidhur me këtë mungesë likuiditeti, pasi subjektit i kaloi barra e provës, ajo paraqiti shpjegimet e saj si dhe vërtetimin e datës 28.03.2019 lëshuar nga Ambasada Franceze në Shqipëri, me të cilin vërtetohet se udhëtimi prej 29 ditësh, nga data 02.07.2005 - 30.07.2005, ka qenë udhëtim zyrtar, duke pretenduar se shpenzimet për këtë udhëtim, nuk duhen marrë në konsideratë në analizën financiare për vitin 2005.

Pas administrimit të vërtetimit të datës 28.03.2019, lëshuar nga Ambasada Franceze në Shqipëri, Komisioni, e vlerësoi të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit dhe çmoi që, shpenzimet për këtë udhëtim të hiqen nga përllogaritjet e shpenzimeve për vitin 2005, për shkak se udhëtimi ka qenë për arsye pune.

Në përfundim, pas rishikimit të analizës financiare për këtë vit, rezultoi se subjekti ka një likuiditet të pajustificuar në shumën prej 65,044 lekësh, si në tabelën më poshtë:

1	Pasuri	500,000
	Pasuri tokë me sip.1000 m ² , në fshatin ***, Shkodër, me pjesë takuese: 25%	500,000
2	Të ardhura	817,488
	Të ardhura nga paga e subjektit të dokumentuara	817,488
3	Shpenzime	172,986
	Shpenzime jetese	160,714
	Shpenzime udhëtimi sipas <i>TIMS</i>	12,254
4	Likuiditete në fillim të vitit	0
	Gjendje <i>cash</i>	0
5	Likuiditete në fund të vitit	209,563
	Gjendja e llogarisë së subjektit në “Raiffeisen Bank”	9,563
	Gjendje <i>cash</i>	200,000
	Diferenca (2+4-1-3-5)	-65,044

Duke qenë se subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* në deklaratën periodike të vitit 2003 dhe atë të vitit 2004, pasi është pyetur, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ajo ka deklaruar se ka pasur kursime *cash* për të dyja këto vite, konkretisht, në shumën 350.000 lekë gjendje *cash* për vitin 2003 dhe 500.000 lekë gjendje kursimesh *cash*, për vitin 2004, por nuk i ka deklaruar ato. Duke pranuar pasaktësitë në deklarime, znj. Albana Boksi sqaron se shkak për mosdeklarimin ka qenë fakti se punonte dhe jetonte larg familjes, si dhe ka mbajtur të ardhura aq sa i nevojiteshin për të jetuar.

Me qëllim verifikimin, nëse subjekti ka pasur mundësi për kursime për periudhën deri në vitin 2003, si dhe për vitin 2004, është bërë analizë financiare për këto periudha, si në tabelat më poshtë:

VITI 2003	
Të ardhura të subjektit	619.743
Shpenzime jetese	-160.714
Diferenca e mundshme për kursim	459.029

VITI 2004	
Të ardhura të subjektit	874.475
Shpenzime jetese	-160.714
Diferenca e mundshme për kursim	713.761

Siç shihet, subjekti ka pasur mundësi financiare gjatë vitit 2003, si dhe në vitin 2004, të krijojë kursimet e pretenduara. Por, duke qenë se, subjekti nuk i ka deklaruar këto kursime në deklaratat periodike përkatëse për këto vite, sipas parashikimit të nenit 4, germa “d” të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, shuma e tyre, nuk është përfshirë në analizën financiare për vitin 2005.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni vlerësoi se për vitin 2005, subjekti ka pasur një likuiditet të pajustificuar në shumën prej 65.044 lekësh. Nisur nga vlera e ulët, (por dhe nga fakti se subjekti ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për të krijuar kursime gjatë deri në vitin 2003 dhe vitin 2004), Komisioni çmoi se, kjo shumë nuk duhet të merret në konsideratë gjatë procesit përfundimtar të vendimmarrjes, duke vlerësuar përfundimisht se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme për të justifikuar pasuritë në raport me shpenzimet e kryera, gjatë periudhës së rivlerësimit 2003 - 2016.

4. Të ardhurat, gjendje, datë 23.01.2017 (kursime në total)380.564 lekë. Pjesa takuese 100%.

- gjendje në llogari rrjedhëse;³¹
- gjendje *cash* në vlerën 200.000 lekë.

Bazuar në analizën financiare të vitit 2016, rezultoi që subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar kursimet e deklaruara në llogari rrjedhëse dhe gjendje *cash*, si më sipër.

³¹ Nga informacioni i administruar në dosjen e Komisionit, konfirmohet se gjendja në llogarinë rrjedhëse të subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank” datë 23.01.2017, është 380.564 lekë.

Në lidhje me personin e lidhur, B.B., babai i subjektit :

Nga hetimi administrativ, me të dhënat e dërguara nga ZVRPP Shkodër³² u vertetua se në emër të B. E. B., rezultojnë të regjistruara dy pasuri te paluajtshme:

➤ Pasuria nr ***, ZK ***, truall me sip. 675 m² + 83 m² ndërtesë.

Kjo pasuri, u vërtetua të jetë fituar nga z. B.B., me aktin e pjesëtimit vullnetar të pasurisë së paluajtshme me nr. ***, datë 09.04.2012, i cili ka për objekt pjesëtimin e pasurisë me sip. truall 1545 m² dhe ndërtesë me sip. 155 m², ndodhur në lagjen “****”, Shkodër, në bashkëpronësi të shtetasve B.(B) B., dhe Xh.B., të fituar me vendimin nr. ***, datë 14.06.1994, të KKKP-së, ish-pronarëve, Shkodër si dhe deklaratës për heqje dorë nga pronësia nr. ***, datë 15.12.1994.

➤ Pasuria nr. ***, ZK ***, truall me sip. 200m².

Pasuria truall, me sip. 200 m² është në bashkëpronësi të shtetasve B.B., e Xh.E.B., S.E.B., dhe M.E.B. Kjo pasuri është fituar me vendimin nr. ***, datë 14.06.1994, të KKKP-së, të ish-pronarëve, Shkodër.

Pra, siç rezulton, pasuritë në emër të babait të subjektit, janë fituar me trashëgim nga ana e tij, dhe për këtë arsye nuk ngrihen dyshime lidhur me përfitimin e tyre, për shkak të pozicionit të subjektit të rivlerësimit, znj. Albana Boksi. Ndërkohë, nga informacioni i vënë në dispozicion nga ZRVPP-të në rrethe, nuk rezultoi që nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. M.B., të ketë në pronësi të saj pasuri të paluajtshme.

DETYRIME FINANCIARE

Gjatë hetimit administrativ, janë kryer hetime në lidhje me detyrimet financiare të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”, si vijojnë:

1. Detyrim ndaj të tretëve (huamarrje) në shumën 10.000 euro.

Kjo hua i është dhënë subjektit nga shtetasi Ç.Xh.B., (për blerje - porositje apartament banimi), pa interes dhe pa afat, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 11.05.2015. Ky detyrim nuk është shlyer nga ana e subjektit.

2. Kontratë kredie e llojit *leasing*, me “Tirana Bank”, për blerje automjeti. Shlyerja e kredisë në vlerën 6.000 euro ka filluar nga data 17.08.2010, për një afat 5-vjecar. Kontrata e kredisë *leasing* ka përfunduar, më datë 17.07.2015, kur automjeti ka kaluar në pronësi të subjektit. Kredia është shlyer plotësisht.

Kjo kontratë dhe përmbushja e detyrimeve të saj është verifikuar me shkresën nga “****”³³. Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të shlyer qiranë financiare në shumën prej 6.000 eurosh.

3. Kredi për blerje shtëpie/apartament, në shumën 4.000.000 lekë, me afat 10 vjet ose 120 muaj, afat që ka filluar që nga dita e disbursimit të kredisë, më datë 01.03.2016.

³² Shih shkresën kthim përgjigje Nr. ***prot, datë 24.10.2018 nga ZVRPP Shkodër në dosjen e Komisionit

³³ Vërtetim, datë 31.03.2016, “****”.

“Raiffeisen Bank”³⁴ ka informuar se znj. Albana Boksi është kredimarrëse pranë “Raiffeisen Bank” për një kredi të marrë, më datë 20.02.2016, në shumën 4.000.000 lekë, me detyrim të pashlyer në shumën 2,564,792.44 lekë.

Kjo kredi është deklaruar në deklaratat periodike si vijon:

- Në deklarinimin për vitin 2016, është deklaruar kontratë kredie për blerje apartament banimi, sipas kontratës së porosisë lidhur, më datë 08.12.2015, për apartamentin me sip. 77.3 m² dhe çmim 7.0340.300 lekë, të ndodhur në Tiranë. Vlera e kredisë së marrë është 4.000.000 lekë. Kredia është marrë me afat 10 vjet ose 120 muaj, e cila ka filluar nga data e disbursimit të kredisë/lidhjes së kontratës, datë 01.03.2016 dhe përfundon, më datë 01.03.2026, me kontratë kredie bankare dhe hipoteke nr. ***, datë 20.02.2016.

- Është deklaruar në deklaratën për “Vetting”, si në pikën 3 më sipër.

Nuk ka pasaktësi apo paqartësi në deklarime. Po kështu, nga analiza financiare rezultoi se, subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e shlyerjes së kredisë.

4. Marrëveshje për përdorim kartë krediti “***”, nga “Raiffeisen Bank”, me limit prej 2.000 eurosh, me gjendje 0 leke, deri më datë 23.01.2017, konfirmuar nga “Raiffeisen Bank”³⁵.

Në përfundim të hetimit administrativ, nuk kanë rezutuar problematika e dyshime në lidhje me detyrimet financiare.

Në lidhje me adresat e banimit :

Gjatë hetimit administrativ, u konstatuan paqartësi në lidhje me adresat e banimit të deklaruara në deklaratat periodike nga ana e subjektit të rivlerësimit, për shkak se:

1. Në deklaratat periodike për vitet 2003, 2005 dhe në vazhdim, si dhe në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar si adresë banimi, Rr. “***”, nr. ***, Tiranë, adresë në të cilën nuk figuroi të jetë regjistruar ndonjë pasuri e paluajtshme në emër të subjektit të rivlerësimit.

Në përgjigjet e pyetësorit të parë, lidhur me adresën e parë Rr. “***”, nr. ***, subjekti sqaron se: ³⁶ “... përpara regjistrimit në Njësinë Administrative Nr. *** (ku subjekti banon sot), kam qenë e regjistruar në zyrën e gjendjes civile të Njësisë Administrative Nr. ***, me adresë: Rr. “***”, nr. ***, por, në fakt, nuk kam jetuar asnjë ditë në këtë adresë, e cila është shënuar nga punonjësja e gjendjes civile në momentin kur kam bërë transferimin e gjendjes civile nga qyteti i Shkodrës në qytetin ne Tiranës (viti 2003).”

Duke qenë se, edhe në vijim, subjekti ka vazhduar ta deklarojë këtë adresë, u pyet përsëri dhe në vijim ajo ka sqaruar se ³⁷: “... ka shënuar këtë adresë, pasi formulari i deklarimit vjetor të pasurisë ka një rubrikë që kërkon ‘adresën ku jeni të regjistruar në Gjendjen Civile’ dhe adresa në ***, ka qenë e regjistruar në gjendjen civile...”

³⁴ Shih shkresën kthim përgjigje nr. ***prot., datë 18.09.2018, të “Raiffeisen Bank” në dosjen e Komisionit.

³⁵ Shih shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 18.09.2018, të “Raiffeisen Bank” në dosjen e Komisionit.

³⁶ Shih përgjigjet e pyetësorit të parë protokolluar me shkresën nr. *** prot., datë 28.06.2018, në dosjen e Komisionit.

³⁷ Shih përgjigjet e pyetësorit të dytë dërguar nga subjekti, më datë 24.10.2018, në dosjen e Komisionit.

Pasi është pyetur se si është bërë regjistrimi në këtë adresë, subjekti ka vënë në dispozicion kopje të akteve të marra nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Nr. ***, Tiranë,³⁸ nga ku rezulton se regjistrimi në këtë zyrë është bërë mbi bazën e kërkesës së subjektit, datë 02.10.2003, dhe vërtetimit të lëshuar nga Njësia Administrative Nr. ***, ku vërtetohet fakti se subjekti banon në adresën: Rr. “****”, nr. ***.

Përveç sa më sipër, nuk rezultoi asnjë e dhënë që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur në posedim apo në pronësi një banesë me këtë adresë banimi. Për këto arsye, Komisioni, krijoi bindjen se arsyeja e deklaramit të adresës së banimit, Rr. “****”, nr. ***, Tiranë, në deklaratat periodike të lartpërmendura, ka qenë për arsye se në gjendjen civile subjekti ka figuruar i regjistruar në këtë adresë banimi.

2. Në përgjigje të pyetësorit të parë tip, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar dy adresa të tjera si vijojnë:

- deri në janar të vitit 2015, subjekti ka jetuar në adresën, Rr. “****”, nd. ***, h. ***, ap. ***, Njësia Administrative Nr. ***, apartament në pronësi të shtetasit A.D.;

- në periudhën shkurt 2015 - dhjetor 2015, subjekti ka jetuar në adresën, Rr. “****”, pallatet “****”, h. ***, shk. ***, Njësia Administrative Nr. ***, apartament në pronësi të shtetasit S.B.

Pasi u konstatua se këto dy adresa nuk janë deklaruar asnjëherë ndër vite, u pyet subjekti në lidhje me mosdeklarimin e tyre, si dhe në lidhje me përdorimin e këtyre pasurive, sqaron se,³⁹ *...nuk i ka deklaruar këto adresa ... nisur edhe nga fakti që deri në vitin 2015 në qytetin e Tiranës nuk ka pasur një adresar apo adresa të sakta; fakti që këto dy pasuri nuk ishin në pronësi të saj, si dhe nga fakti që në vitin 2006 ka qenë në pritje të miratimit të ndonjë kredie me kushte lehtësuese, ...pra kanë qenë adresa të përkohshme...*

Në lidhje me përdorimin e apartamenteve në pronësi të shtetasve A.D., dhe S.B, subjekti ka dhënë sqarime dhe ka vënë në dispozicion dokumente shkresore⁴⁰ sipas të cilave subjekti ka banuar përkohësisht në të dyja këto apartamente, pa kontrata shkresore, për shkak të njohjeve që kishte me pronarët e tyre, për të cilat ka paguar shpenzime në vlerën 10.000 lekë në muaj, ndërsa për vitin 2016, ka paguar shumë 10.000 lekë, plus faturat përkatëse të energjisë elektrike, ujit etj., shpenzime të cilat janë përfshirë në analizën financiare.

Gjatë hetimit administrativ, nuk u vërtetua që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur çështje civile apo penale të gjykuara prej saj me palë pjesëmarrëse shtetasit e sipërpërmendur.⁴¹

3. Në deklaramin për vitin 2004, kur subjekti ka qenë me punë në qytetin e Elbasanit, ka deklaruar si adresë vendbanimi, Rr. “****”, p. ***, ap. ***, Tiranë, Njësia Administrative Nr. ***.

³⁸ Shih dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 5, dërguar nga subjekti, më datë 14.03.2019, në dosjen e Komisionit.

³⁹ Shih përgjigjet e pyetësorit të dytë dërguar nga subjekti, më datë 24.10.2018, në dosjen e Komisionit.

⁴⁰ Shih dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr.2, dërguar subjektit, më datë 18.10.2019, në dosjen e Komisionit..

⁴¹ Shih vërtetimin nr. *** prot., datë 23.10.2018, lëshuar nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda dhe vërtetimin nr. *** prot., datë 23.10.2018, lëshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 dërguar subjektit, më datë 18.10.2018, në dosjen e Komisionit.

Lidhur me këtë adresë, subjekti deklaroi se⁴², *kjo adresë është shënuar prej saj, jo si adresë vendbanimi, por për shkak se kjo ishte një adresë e saktë në Njësinë Administrative Nr. ****, (ku që nga tetori 2003 isha regjistruar në këtë gjendje civile,) – për efekt të njoftimeve që mund të vinin nga ILDKPKI-ja dhe KLD-ja, pasi gjatë vitit 2004 deklaroi se ka qëndruar më së shumti në Elbasan dhe jo në Tiranë, fakt i vërtetuar gjatë hetimit administrativ, pasi në këtë vit subjekti ka punuar në Elbasan.

Në përfundim të hetimit administrativ, u qartësuan pikëpyetjet në lidhje me adresat e deklaruara nga ana e subjektit të rivlerësimit. Komisioni, përveç se nuk vërtetoi pasuri të tjera nga ato të deklaruara në deklaratën “Vetting” nga subjekti i rivlerësimit, nuk evidentoi dyshime dhe të dhëna që të tregojnë përfitim nga përdorimi i pasurive në adresat e sipërpërmendura, për shkak të statusit të saj si gjyqtare. Po kështu, Komisioni, mori në konsideratë edhe deklarin e sinqertë të subjektit, në lidhje me përdorimin përkohësisht të apartamenteve në pronësi të shtetasve A.D., dhe S.B., në përgjigjet e pyetësorit standard.

II.2 VLERËSIMI I FIGURËS

Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2017, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Albana B. Boksi, i deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. *** , datë 26.12.2018, në të cilin konkludon se:

- formulari i deklarinimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me ligjin nr. 84/2016;
- ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë subjekti në deklaratën për kontrollin e figurës;
- nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimin të organizuar.

Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit, znj. Albana B. Boksi, për të vijuar ushtrimin e detyrës.

Gjatë hetimit administrativ, pas verifikimeve, është konstatuar plotësimi me saktësi i formularit për kontrollin e figurës nga ana e subjektit të rivlerësimit. Ndërkohë, nuk ka pasur të dhëna, informacione dhe dyshime për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo veprimtari korruptive nga ana e subjektit të rivlerësimit.

II.3 VLERËSIMI PROFESIONAL

Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit, bazuar në:

1. Raportin për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, dërguar me shkresën nr. 3020/3 prot., datë 14.02.2019.

⁴² Shih përgjigjet e pyetësorit të dytë dërguar nga subjekti, më datë 24.10.2018, në dosjen e Komisionit.

2. Informacionin e marrë nga burime të ligjshme; si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga 2 denoncime të publikut sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe ankesat e paraqitura ndaj gjyqtarës Albana Boksi pranë KLD-së sipas shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 19.09.2018 nga KLD-ja.

3. Kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

1. Raporti për analizën e aftësive profesionale i kryer nga KLGJ-ja, është bazuar në:

- Formularin e vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhur nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- Pesë dosjet gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor me shortin e datës 23.11.2018;
- Të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

Në përfundim të analizës, KLGJ-ja, ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit si vijon:

1.1 Në lidhje me aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, znj. Albana Boksi, ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit.

b) Arsytimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, znj. Albana Boksi, harton vendime me strukturë të standardizuar që plotësojnë kërkesat e ligjit procedural penal. Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës në raport me pretendimet e ngritura nga palët gjatë gjykimit dhe respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

1.2 Në lidhje me aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, znj. Albana Boksi, ka aftësitë e duhura për të përballuar ngarkesën në punë.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, znj. Albana Boksi, ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato përgjithësisht kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota.

1.3 Në lidhje me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Subjekti i rivlerësimit, znj. Albana Boksi, ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, më datën 30.07.1997, si dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e

Magjistraturës në vitin 2001. Pas studimeve, më datë 02.10.2001, ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Në vijim, më datë 28.02.2006, gjyqtarja Albana Boksi emërohet në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, ku vazhdon dhe aktualisht. Në periudhën 06.05.2011 - 28.05.2014, gjyqtarja ka ushtruar funksionin e pedagoges së brendshme në Shkollën e Magjistraturës.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, konstatohet se ndaj gjyqtares Albana Boksi nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e KLD-së. Ndërsa, nga të dhënat e regjistrimit për procedimet disiplinore nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtares Albana Boksi.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Albana Boksi, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, znj. Albana Boksi.

1.4 Në lidhje me aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se, gjyqtarja Albana Boksi komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse në seancat gjyqësore.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit, znj. Albana Boksi, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Përveç diplomimit në Shkollën e Magjistraturës, kjo gjyqtare ka vijuar angazhimin e saj për thellimin e njohurive profesionale. Kështu, sipas të dhënave që rezultojnë nga formulari i vetëvlerësimit, gjyqtare Albana Boksi, ka përfunduar “Masterin” në Shkencat Penale në Fakultetin e Drejtësisë, pranë Universitetit të Tiranës, dhe nga viti 2014 e në vazhdim ajo vazhdon studimet e Doktoratës, në proces mbrojtjeje të titullit “Doktor”.

Gjyqtare Albana Boksi, për shkak të funksionit të gjyqtarit të Apelit, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Të dhënat tregojnë se ajo ka qenë shumë e gatshme për t'u angazhuar në aktivitete profesionale. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë në 21 trajnime profesionale, 10 trajnime si ekspert, 2 trajnime si moderatore, 1 trajnim si lehtësuese dhe 8 trajnime si pjesëmarrëse. Këto të dhëna tregojnë se ajo ka marrë pjesë në 37 ditë të formimit vazhdues, për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtares së Apelit për Krime të Rënda. Gjithashtu, ajo ka marrë pjesë edhe në katër aktivitete të tjera profesionale jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës – shih trajnimet në tre vitet e fundit.

Gjyqtarja Albana Boksi për tre vjet rresht ka ushtruar edhe detyrën e pedagoges së brendshme në Shkollën e Magjistraturës, eksperte trajnuese pranë kësaj shkolle, etj.

2. Informacioni i marrë në rrugë zyrtare

Pranë Komisionit janë administruar dhe trajtuar dy denoncime⁴³ nga publiku ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Albana Boksi. Pas analizimit të tyre në raport me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se, ato nuk përmbajnë të dhëna për shkelje ligjore dhe mangësi në drejtim të aftësive profesionale, apo të dhëna për veprime korruptive të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

Pasi janë analizuar pesë dosjet e përzgjedhura me short dhe tre vendimet e përzgjedhura nga subjekti, nga ana e Komisionit u arrit në të njëjtat konstatime si ato të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjatë procesit të rivlerësimit u kërkua informacion nga KLD-ja⁴⁴ lidhur me ankesa apo procedime disiplinore ndaj subjektit, znj. Albana Boksi, nga ku rezultoi se nuk ka pasur asnjë kërkesë/propozim të ardhur nga Ministri i Drejtësisë për procedim disiplinor, e si rrjedhojë, ndaj saj nuk rezultoi të jetë propozuar apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore.

3. Rivlerësimi i aftësive profesionale, është bërë sipas kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe në përfundim të hetimit administrativ, rezultoi se:

- Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi shumë të mira profesionale, sipas nenit 72 të ligjit nr. 96/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi shumë të mira organizative, sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka një nivel të lartë të etikës dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

Në përfundim, sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Albana Boksi, është vlerësuar “i aftë” profesionalisht.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjyqësor ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti ka qenë i gatshëm, duke u treguar tërësisht bashkëpunues, pasi i është përgjigjur me korrektesë brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke dhënë në mënyrë shteruese informacionin e kërkuar, gjë që është mbajtur në konsideratë në marrjen e vendimit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016.

IV. SEANCA DËGJIMORE

⁴³ Shih denoncimin e shtetasit Xh.Rr., dërguar me *e-mail*, më datë 20.11.2017, në adresën elektronike të Komisionit, protokolluar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 29.12.2017, dhe denoncim nga B.R.K., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 12.02.2018, në dosjen e Komisionit.

⁴⁴ Shih shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 19.09.2018, nga KLD-ja në dosjen e Komisionit.

Më datë 04.04.2019, u zhvillua seanca dëgjimore sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Albana Boksi, gjatë së cilës kërkoi konfirmimin në detyrë.

Trupi gjykues i Komisionit, nisur nga rezultatet e hetimit administrativ lidhur me pasurinë, figurën dhe aftësitë profesionale, vlerësoi se procesi i vendimmarrjes në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Albana Boksi, duhet të bazohet në vlerësimin tërësor të tri kriterëve, referuar nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të seancës dëgjimore, trupi gjykues, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionere Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi subjektin, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë, dhe pasi administroi dokumentet shkresore, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Albana Boksi, dhe shpall këtë vendim sot, më datë 05.04.2019, sipas nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 84/2016.

V. KONKLuzion Përfundimtar

1. Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 (kreu IV), lidhur me kriterin e pasurisë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Albana Boksi, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë (neni 59/1, germa “a” e ligjit).

2. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016 (kreu V), lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Albana Boksi, ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës (neni 59/1, germa “b” e ligjit).

3. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016 (kreu VI), rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Albana Boksi, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale (neni 59/1, germa “c” e ligjit).

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, bazuar në nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Albana Boksi, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

2. Vendimi i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 05.04.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

KRYESUES
Etleda ÇIFTJA

ANËTAR/RELATOR
Firdes SHULI

ANËTAR
Pamela QIRKO

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka